




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. Br. Prot. 01-3236/12
 Nr. i faq. Prot.No. 01-3236/12
 Broj stranica Data Datum 13.09.2012
 Nr. pages 02 Date
 PRISHTINË



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.08.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-5087/11, për **z.Agim Zahiti, Drejtor Shëndetësor ne Spitalin "SHEIKH ZAHYED" në Vushtrri**, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka deshmuar se i ka përfunduar mandati si Drejtor shëndetësor i Spitalit "SHEIKH ZAHYED" në Vushtrri, dhe nuk ushtron më atë Funkсион.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në lëndën e trajtuar me nr.AKK-03-5087/11, të dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit janë ndërmarrë veprimet e nevojshme të parapara sipas Ligjit Nr.04/L-051 dhe atyre procedurale sipas nenit 18.1 të po këtij ligji.

Pas informatës se marre gjate kontrollit te formularit për deklarim te pasurisë, ka filluar shqyrtimi i lendes me numër protokolli AKK-03-5087/11,që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Agim Zahiti, Drejtor Shëndetësor në Spitalin "Sheik Zaeyd" në Vushtrri.

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si Drejtor Shëndetësor në Spitalin "Sheik Zaeyd" në Vushtrri, ka qene i regjistruar ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve ARBK, si person i autorizuar dhe pronar ne biznesin "O.S.GJ-NENA" e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 01.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z.Agim Zahiti, Drejtor Shëndetësor në Spitalin "Sheik Zaeyd" në Vushtrri, nuk është lajmëruar dhe nuk ka komunikuar me Agjencinë deri sa është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë për ta pyetura se a është i njoftuar për fillimin e procedurës për trajtimin e situatës së konfliktit të mundshëm të interesit, gjatë këtij komunikimi z.Zahiti, është përgjigjur se e ka marrë shkresën por nuk e ka kuptuar për çfarë është fjala dhe për shkaqe personale nuk ka mundur ta kontaktoj Agjencinë. Zyrtarët e Agjencisë e kanë njoftuar për situatën dhe nga ai kanë marrë premtimin se shumë shpejt do të marrë vendimin se cilin postë do ta mbajë.

Me datën 04.05.2012 e kemi kontaktuar z.Zahiti për ta pyetur se a i ka bërë ndryshimet e nevojshme, të kërkuara nga Agjencia, nga ai kemi marrë përgjigjen se brenda disa ditësh, do ta njoftoj Agjencinë me shkrim.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 09.08.2012, ka pranuar njoftimin nga zyrtarët e personelit të Ministrisë së Shëndetësisë, ku e njoftojnë Agjencinë se z.Agim Zahiti, Drejtor Shëndetësor në Spitalin "Sheik Zaeyd" në Vushtrri, nuk është me në pozitën e Drejtorit, por në vend të tij është zgjedhur një person tjetër.

Andaj në bazë të dëshmimeve dhe fakteve konstatojmë se :

Zyrtari i lartë z.Agim Zahiti, Drejtor Shëndetësor në Spitalin "Sheik Zaeyd" në Vushtrri, është larguar nga funksioni i drejtorit dhe nuk është me në pozitën e zyrtarit të lartë, dhe e ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej, pasi që nuk ushtron me pozitën e Drejtorit. Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si, Drejtor Shëndetësor në Spitalin "Sheik Zaeyd" në Vushtrri, dhe si person i autorizuar dhe pronarë në biznesin "O.S.GJ-NENA".

Konstatojmë se pas ndryshimeve që janë bërë dhe gjendjes faktike tash, z.Agim Zahiti nuk gjendet në situatën e konfliktit të Interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

